

# **DRAMA BOTERORE MODERNE E POSTMODERNE NE RAPORT NE DRAMEN SHQIPTARE TE SE NJEJTES TIPOLOGJI.**

## **VESHTRIM KRAHASUES...**

**Ernestina Halili**

Faculty of Philology, Tirana University ,Email: erenestina@gmail.com

### **Abstract**

Duke qenë se rrjedha të rëndësishme të dramës shqipe të lëvruar në Kosovë, i përkasin poetikave letrare moderniste, është e domosdoshme të flasim shkurt edhe për parimet kryesore që zotërojnë në këto rrjedha, përvoja dramatike e rryma letrare. Qëllimi është për të nxjerrë në pah ato parime dhe veçori, të cilat na shfaqen edhe si parime e veçori që kanë udhëhequr dhe i dallojnë veprat e tyre. Në përputhje me zhvillimet e teatrit bashkëkohor, ritmit të shoqërisë, teknologjive moderne të instaluar në agregatat e skenës; përputhur zhvillimeve të vetë gjinisë dramatike, impaktit, si dhe marrëdhënies që ajo krijon me lexuesit dhe posaçërisht me publikun e kohës, drama moderne në Kosovë në fund të viteve '60 dhe fillim të viteve '70 nisi të parapëlqejë tipologjinë e dramës absurde, që ishte në modë asokohe. Ajo bëhet më poetike, domethënë më abstrakte. Më pranë saj janë elemente e mbivendosje ndjesore të tilla si paradoksalja, e veçanta dhe e çuditshmja, teatraliteti i gjestit, i veprimit, i mjedisit dhe pakësimi i fjalëve, simbolika e dekoreve dhe e objekteve të rekuizitës, strukturimi i subjektit si ëndërrim (e huajtur nga surrealistët), prania e monologut të brendshëm si strukturë bazike, përzierja e kohëve me vetëdije duke krijuar një “kohë në kohë” apo një “antikohë”, që identifikohet më “kohën psikologjike” pa caqe fizike të matshme, e kthyer nga përbrenda, si shprehje e pështjellimit psikik të personazhit. Nga një pamje gjithëpërfshirëse, mund të vihet re se drama dhe dramaturgët shqiptarë në Kosovë që ndjekin parime të letërsisë moderne, nga fundi i viteve '60 e deri sot, gjithnjë e më mirë, nga pikëpamja strukturore, kanë shfrytëzuar e shfrytëzojnë elementë dhe komponentë të tillë të si: 1. befasia, e shprehur në të papriturat e shumta gjatë ecurisë së aksionit dramatik, sidomos me fundet paradoksale e të pahamendësuara, 2. kontrapunkti, që shfrytëzohet si element i kudogjendur midis personazheve, personazhit dhe situatës, personazhit dhe mënyrës së zgjidhjes së konfliktit, fjalës dhe veprimit, asaj çka thuhet dhe asaj çka nënkuptohet qartësisht etj, 3. ritmi i shpejtuar, që përfshin gjithë komponentët dhe shndërrohet në situatë (në pjesët e Joneskos ritmi nxitet deri në ekstrem, kurse te Beketi më pak, duke u shndërruar natyrshëm në situatë). 4. riciklimi dhe qarqet e mbyllura. Dendur në dramën moderne shfrytëzohen të ashtuquajturat “struktura rrotulluese”, kur fundi bëhet huazimi i fillimit të pjesës skenike, ose i fillimit të episodit, i fillimit të aktit gjer edhe i gjestit pararendës. Jo vetëm dramaturgët e absurdit si Jonesko, veçanërisht Beketi, por edhe Brehti i ka përdorur elemente të tilla, madje edhe Sartri e Kamy, por në një koncept më të

gjerë, që përfshin krejt korpusin filozofik të veprave, kur mendimi artikullohet fillimisht në paraqitjen hyrëse të dramës dhe rinis sërishmi, si një qark i mbyllur, në fund të saj.

Qellimi I kumteses përfshin pikërisht hedhjen drite mbi lindjen e zhvillimin e drames moderne, si modul i gjinise me komplekse të letërsisë. Në kumtesë do të krahasohen autore dhe tipologji.